

Informatizimi, Poçi firmos marrëveshjen në Beograd

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit ka firmosur marrëveshjen për informatizimin e shoqërisë. Implementimi i saj, si nismë e Paktit të Stabilitetit, synon që në vitet në vazhdim shumë shërbime publike dhe qeveritare të kryhen "online"

Shqipëria ka firmosur marrëveshjen për zhvillimin e informatizimit të shoqërisë, prej së cilës gjatë viteve në vazhdim mund të kryhen nëpërmjet internetit edhe disa shërbime qeveritare. Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit Spartak Poçi, firmos këto ditë në Beograd, marrëveshjen, realizimi i së cilës u bë në kuadër të Paktit të Stabilitetit me pjesëmarrës, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë, Moldavinë, Malin i Zi, Serbinë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë, si dhe përfaqësues të Bashkimit Evropian. Implementimi i saj synon të krijojë terren për përfundim të vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian, sidomos në fushat e administratës civile, të biznesit, doganave etj. Në marrëveshje përcaktohen dhe detyrimet shtetërore ndaj shoqërisë civile dhe mbrojtja e informacionit personal të individit si edhe etapat për realizimin

e saj. Ekspertët në Drejtorinë e telekomunikacioneve në MTTI, thanë se përfshirja e Shqipërisë në informatizimin e shoqërisë e integron atë me shtepjtë në vendet me të zhvilluara ekonomike. Informacioni po konsiderohet sot si një nga promotorët e rritjes ekonomike, shkëmbimi i të cilit nëpërmjet internetit, ndihoi me 4 për qind në kretë rritjen e ekonomike të SHBA-së vitin e kaluar. Marrëveshja që ka nënshkruar Shqipëria dy ditë më parë në Beograd, synon që gradualisht shoqëria shqiptare të jetë përdoruesë e të gjitha teknikave të informimit të shtepjtë. Në një fazë të mëvonshme implementimi i kësaj marrëveshjeje synon shkëmbimin e informacionit dhe nënshkrimin e marrëveshjeve qeveritare në distancë. Po kështu, synohet që shumë shërbime publike si: shëndetësia, arsimi dhe pagesa të ndryshme të ofrohen nëpërmjet



Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Spartak Poçi. **USA**
internetit. Mirëpo, që të realizohet kjo, ekspertët rekomandojnë, dhënjën e licensave ndaj operatorëve private që ofrojnë shërbimet moderne të komunikimit ku përfshihet edhe interneti. **B.H.**

TEC i ri në Vlorë, BB miraton studimin

Selia e Bankës Botërore në Shqipëri e ka vlerësuar të financueshëm studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një TEC të ri në Vlorë. Studimi i shpërndarë për oponencë në institucione këto ditë nga Ministria e Energjitikës, rezultoi më i pranueshëm se studimi i fizibilitetit për hidrocentralin e Bushatit

Blerina HODJA

Banka Botërore e konsideron të financueshëm projektin e fizibilitetit për ndërtimin e një TEC të ri në Vlorë, i cili ka përfunduar së hirtuar nga kompania "Harza" disa ditë më parë. Burimet nga selia e BB në Shqipëri, i bënë të ditur "Korrierit", se studimi i TEC është shumë më fizibel edhe se projekti që është hartuar për ndërtimin e hidrocentralit të Bushatit. Si rezultat i këtij vlerësimit projekti është totalisht i financueshëm dhe se për ndërtimin e tij, Banka Botërore ka miratuar në parim kohë më parë një shumë prej 20 milionë dollarësh. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, ka përfunduar këto ditë studimin e fizibilitetit për vepërimet e re të prodhimit të energjisë dhe e ka dorëzuar atë për

Të dhëna për TEC-in e ri
• Totali i fuqisë së instaluar për prodhimin e energjisë elektrike 300 MegaVat
• 100 MV do të instalohen gjatë fazës së parë me financime të Institucioneve financiare ndërkombëtare
• 200 MV të tjera do të instalohen nga investitorët privatë
• Projekti i fizibilitetit kushtoi 750 mijë USD
• Vlera e ndërtimit llogaritet rreth 400 milionë USD
• Vënja në oficisë llogaritet në 2004

oponencë në institucione, në të cilat përfshihen shumica e ministrive të qeverisë shqiptare dhe institucione të tilla ndërkombëtare si Banka Botërore Fondi Monetar ndërkombëtar etj. Pasi, të jenë dhënë vlerësimet në lidhje me vlefshmërinë e projektit atëherë TEC do të futet në procedurat e tenderimit, pohan burimet zyrtare në Ministrinë e Energjitikës. Nga informacionet paraprake,

mësohet se studimi ka marrë "OK" e disa prej institucioneve më të rëndësishme prej të cilave varen edhe financimet për ndërtimin e tij. Kosto e një kilovatit energji, sipas studimeve përfshin një vlerë prej 4, 5 lekë, e cila sipas ekspertëve të energjisë më mirën e çmimit të këtij produkti do të justifikohet tërësisht. Procesi nëpër të cilin do të kalojë ndërtimi i vepres me të re të sektorit të energjitikës

përfshin 4 faza, 3 prej të cilave pothuajse janë ezauaruar. Së shpejti, studimi i fizibilitetit pritet të kalojë në proces tenderimi dhe në gjashtë muajt e parë të vitit 2003, do të përzgjidhet kompania që do të merret me ndërtimin. Në fazën e parë të do të instalohen 100 MV dhe financimet do të sigurohen nga organizatat financiare ndërkombëtare. Kjo fazë pritet të përfundojë gjatë një vit dhe më pas për më dy vite të tjera do të fillojë nga montimi i një kapacitet prej 200 MV të reja.

Instalimi i kësaj fuqie është llogaritur të realizohet nëpërmjet dhënjës me koncesion investitorëve private, të cilët do të përfundojnë këtë fazë për rreth dy vite. Ndërtimi i kësaj vepre mbetet e vetmija mundësi për zbutjen e dritë të krizës energjitike.

BB mbështet rritjen e çmimit të energjisë

Banka Botërore e mbështet rritjen e çmimit të energjisë elektrike si prioritet që qeveria shqiptare e ka shpallur në Dokumentin e Politikave Energjitike. Sipas saj, është në të drejtën e qeverisë të ndërmarë vendime të mbështetura në politikat dhe strategjitë e miratuara nga vetë ajo, për reforma në sistemin elektroenergjik shqiptar. Në këtë kuadër parashikohet edhe rritja e çmimit të energjisë, e cila ndërmerret si një hap për përmirësimin e gjendjes financiare të KESH dhe uljen e kostove në buxhetin e shtetit. Kështu, sipas burimeve në Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës me 1 janar të vitit 2003 do të fillojë zbatimi i tarifave të reja të energjisë. Mesatarja e çmimit të një kilovatit energji aktualisht është 4,7 lekë, ndërsa ky nivel pritet të shkojë në 7,5 lekë. Institucionet e energjitikës përfundojnë për studimin me tarifave të reja, i cili gjatë këtyre dy muajve do të bëhet gat për miratim në organet ligjvënës.

KESH, 4500 debitore në gjykatë

Gjykatat dhe zyrat e Përbërimit po bashkëpunojnë për trajtimin e fakturës së energjisë elektrike "Titull Ekzekutiv", tha dje drejtori i KESH, Andis Harasani në një takim me drejtorin e Përgjithshëm të ENEL, Paolo Scaroni. Vizia e tij në vendin tonë, një foto në zyrë e shpëtit në KESH, ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit ndërmjet KESH dhe kompanisë italiane të elektroenergjikës. Harasani tha se në zbatim të ligjit për fatërn e energjisë elektrike si Titull Ekzekutiv, gjatë 8 muajit të vitit 2002 janë në gjykatë, rreth 4500 subjekte. Të cilat janë debitore në KESH me shumta të ndryshme. Prej këtyre është arritur të shlyhet faktura e detyrimit nga rreth 350 subjekte. Gjatë takimit të dy drejtuesit kanë kanë biseduar për thellimin e bashkëpunimit me projekte konkrete. Së shpejti pritet të vizitojë Koooperatën Elektroenergjitike Drejtori i ENEL, Scaroni. ENEL praj dy vjetësh bashkëpunon me KESH, kryesisht për përmirësimin e treguesve financiarë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I MINISTRAVE

Departamenti i Administratës Publike

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", Departamenti i Administratës Publike shpall konkurrimin për 1 vend të lirë, në pozicionin

Drejtor i PMU Phare Cross Border në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 12 të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil".

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar fakultetin Ekonomik ose Fakultetin e Inxhinjerisë së Ndërtimit, nota mesatare mbi 7.
- Të ketë jo më pak se 7 vjet eksperiencë pune, përbën avantazh përvoja e punës në administratë publike.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze, përbën avantazh njohja e një gjuhe të dytë.
- Të njohë mirë programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi komunikuese, koordinuese dhe menaxhuese.

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit Njoftim për vend të lirë pune

PAGA

Paga bruto e pozicionit të kërkuar 74 000 + 9 000 (+2% shtesë mbi 9000 për çdo vit vijetëri pune) lekë në muaj.

Paraqitja e dokumentave

Kandidati duhet të paraqesë bredna datës 02.12.2002 në kutinë postare me nr.1751 këto dokumenta: Kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe të listës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmitave të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit nëse ka, si dhe të paktën një letër rekomandimi. Mosparaqitja e plotë e dokumentave përbën skuallfikim të kandidatit.

KONKURIMI

Konkurimi është i hapur për nëpunësit civil ekzistues nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë si dhe për kandidatët jashtë administratës publike nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil. Pas verifikimit paraprak, më datë 05.12.2002 në selinë e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit do të shpallet lista e konkurrentëve, që do të vazhdojnë me tej konkurrimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkëmbim të intervistave me tej. Konkurrimi do të bazohet mbi njohuritë rreth Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mbi "Practical Guide" e Programit Evropian AID.

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendeve të lira mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al